



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2230/ Prot.

Tepelenë, më 03.08.2026

RAPORT

MBI ZHVILLIMIN E DËGJESËS PUBLIKE PËR PROJEKTAKTIN

“Për miratimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, Këshilli Bashkiak Tepelenë zhvilloi procesin e dëgjësë dhe konsultimit publik me komunitetin lidhur me projektaktin “Për miratimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029”, të propozuar nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në përputhje me Rregulloren për Konsultimin Publik.

Në kuadër të këtij procesi u konsultuan grupet e interesit, veçanërisht qytetarët e Bashkisë Tepelenë. Për këtë qëllim u organizuan 3 takime publike, në të cilat morën pjesë gjithsej 113 persona, nga të cilët 88 burra dhe 25 gra.

Gjatë takimeve publike u paraqitën gjithsej 28 rekomandime nga pjesëmarrësit.

Përmbledhja e rekomandimeve të mbledhura gjatë procesit të konsultimit publik iu dërgua për opinion Kryetarit të Bashkisë Tepelenë. Në përgjigjen e tij, Kryetari i Bashkisë shprehu dakordësinë për 21 rekomandime. Rekomandimet e tjera do të vijojnë të shqyrtohen dhe të adresohen në bashkëpunim me institucionet dhe strukturat përgjegjëse.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Ekonomisë, në mbledhjen e zhvilluar më datë 04.08.2026, pasi shqyrtoi secilin rekomandim të paraqitur nga komuniteti, si dhe opinionin e Kryetarit të

Bashkisë, vendosi të marrë në konsideratë 21 rekomandime dhe të mos marrë në konsideratë 0 rekomandime.

Raporti përkatës i Komisionit iu paraqit Këshillit Bashkiak Tepelenë për shqyrtim së bashku me materialet shoqëruese të procesit të konsultimit publik.

Këshilli Bashkiak Tepelenë, në mbledhjen e datës 05.08.2026, miratoi Vendimin nr. 56, datë 05.08.2026, “Për miratimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 të Bashkisë Tepelenë”, duke marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga komuniteti dhe duke mos lënë pa marrë në konsideratë asnjë rekomandim.

Këshilli Bashkiak Tepelenë, në cilësinë e përfaqësuesit të komunitetit, falënderon të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre në procesin e konsultimit publik dhe siguron se opinionet dhe rekomandimet e tyre do të vazhdojnë të merren në konsideratë, me qëllim përmirësimin e procesit të vendimmarrjes dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve në funksion të komunitetit.

Materialet që lidhen me procesin e konsultimit publik mund të gjenden në **Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike**, në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak Tepelenë.

<https://tepelena.gov.al/regjistri-elektronik-i-konsultimit-publik/>

SEKRETAR KËSHILLIT

Valbona ÇELA

